



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

NR _____, datë _____

PER STRATEGJINE E MJEDISIT DETAR¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 8/1, gërma a dhe nenit 101/1 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. OBJEKTI

1. Objekt i këtij Vendimi është mjedisi detar nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, i ndarë në rajone dhe nënrajonë detare dhe statusi mjedisor i tyre.

II. QELLIMI

2. Ky vendim synon:

- a) Krijimin e kuadrit të plotë për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit ujor për të gjithë ujërat detare, për të parandaluar përkeqësimin e tij ose, kur është e praktikisht e mundur për të rehabilituar ekosistemet detare në zonat ku ato kanë pësuar ndikime negative;
- b) Parandalimin dhe pakësimin gradual deri në ndalimin e ndotjes, për të shmangur ndikimet negative ose rreziqet ndaj biodiversitetit dhe ekosistemeve detare, shëndetit të njerëzve dhe përdorimit të ligjshëm të detit.
- c) Përcaktimin e metodologjive standarde për hartimin e strategjisë detare;
- ç) Integrimin e çështjeve mjedisore në politikat e ndryshme dhe në marrëveshjet për masat administrative dhe ligjore që mund të kenë ndikim në mjedisin detar.
- d) Hartimin e strategjive të mjedisit detar në bazë ekosistemi në mënyrë që presioni i përgjithshëm i aktivitetit njerëzor të mund të lejohet:
 - i. arritjen e statusit të mirë të mjedisit detar dhe që
 - ii. aftësia e ekosistemeve detare për t’ju përgjigjur ndryshimeve të shkaktuara nga njeriu të mos çënohet, duke mundësuar përdorimin e qëndrueshëm të të mirave dhe shërbimeve të detit nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

¹ Ky vendim transponon Direktivën 2008/56/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të dates 17 Qershor 2008, e cila përcakton kuadrin për veprimet në komunitet në fushën e politikës mjedisore detare (Direktiva Kuadër e Strategjisë Mjedisore Detare)

III. FUSHA E VEPRIMIT

3. Ky vendim zbatohet për:
 - a) të gjitha ujërat detare duke marrë në konsideratë ndikimet ndërkufitare në cilësinë e mjedisit detar të vendeve të tjera në të njëjtin rajon apo nënrajon detar;
 - b) çdo zonë të detit që shtrihet brenda kufijve të zonës ekonomike ekskluzive, përfshirë shtratin dhe nëntokën e detit në atë zonë;
 - c) zonën e detit të territorit detar ngjitur me Republikën e Shqipërisë në drejtim të kufirit të saj detar, përfshirë shtratin dhe nëntokën e detit në atë zonë;
 - ç) vijën kufitare ndarëse ndërmjet ujërave tokësore, bregdetare dhe detare të përcaktuara sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Ky vendim nuk zbatohet në veprimtaritë që synojnë mbrojtjen e sigurisë kombëtare.
5. Në rastin e veprimtarive të referuara në paragrafin 4 Ministria në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen, sic parashikohet edhe në nenin 5 gërma b të ligjit "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" marrin masa që edhe këto veprimtari të kryhen sa më shumë në përputhje me qëllimet e këtij vendimi.

IV. PERKUFIZIME

6. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) "**AKM**" është Agjensia Kombëtare e Mjedisit sipas kuptimit që jepet në Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
 - b) "**Bashkëpunim rajonal**" është bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera, që ndajnë të njëjtin rajon ose nënrajon detar, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e strategjive detare;
 - c) "**Burime ujore**" ka kuptimin që jepet në Ligjin No. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore";
 - ç) "**ISHM**" është Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit;
 - d) "**Konventë rajonale e detit**" është çdo konventë ose marrëveshje ndërkombëtare së bashku me organet përkatëse drejtuese e themeluar me qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të rajoneve detare ku Shqipëria është palë.
 - dh) "**Kriteret**" janë veçoritë dalluese teknike që janë të lidhura ngushtë me treguesit cilësorë.
 - e) "**Minister**" është ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit;
 - ë) "**Ministria**" është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
 - f) "**Mjedis detar**" ka kuptimin që jepet në Ligjin Nr. 9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë";
 - g) "**Ndotje**" është futja e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mjedisin detar, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave apo e energjisë, e zhurmave në thellësi të ujërave, që shkaktojnë apo mund të shkaktojnë efekte të dëmshme mbi burimet e jetesës dhe ekosistemet detare, përfshirë humbjen e biodiversitetit, rreziqet për shëndetin e njeriut, pengimin e veprimtarive detare, përfshirë turizmin, peshkimin, argëtimin dhe përdorime të tjera të ligjshme të detit, dëmtimin e cilësisë së ujit të detit dhe reduktimin e të mirave ose në përgjithësi dëmtimin e përdorimit të qëndrueshëm të të mirave dhe shërbimeve detare.
 - gj) "**Objektiv mjedisor**" është deklarimi nga pikpamja cilësore ose sasiore e kushteve të dëshiruara të komponentëve të ndryshëm, presionit dhe ndikimeve mbi ujërat detare, në lidhje me çdo rajon apo nënrajon detar.
 - h) "**Rajoni detar**" është rajoni detar i përcaktuar në Kreun V më poshtë. Rajonet detare dhe nënrajonet e tyre janë përcaktuar për të lehtësuar zbatimin e këtij vendimi dhe janë ndarë duke marrë parasysh veçoritë hidrologjike, oqeanografike dhe biogeografike të tyre.

- i) **“Status mjedisor”** është gjendja e përgjithshme e mjedisit në ujërat detare, duke marrë parasysh strukturën, funksionin dhe proceset e ekosistemeve përbërëse detare së bashku me faktorët fiziografikë, gjeografikë, biologjikë, gjeologjikë dhe klimatikë, si dhe kushtet fizike, akustike dhe kimike, përfshirë ato që rezultojnë nga veprimtaria e njeriut brenda ose jashtë zonës në fjalë;
- j) **“Status i mirë mjedisor”** është statusi mjedisor i ujërave, aty ku këto ofrojnë oqeanë dhe dete ekologjikisht të ndryshme dhe dinamike që në vetvete janë të pastër, të shëndetshëm dhe produktivë, dhe ku përdorimi i mjedisit detar është i qëndrueshëm dhe ruan potencialin për përdorimin dhe veprimtaritë e brezave të sotëm dhe të ardhshëm, dmth:
 - i. Struktura, funksionet dhe proceset e ekosistemeve përbërëse detare, së bashku me faktorët shoqërues fiziografikë, gjeografikë, gjeologjikë dhe klimatikë, lejojnë që këto ekosisteme të funksionojnë plotësisht dhe të ruajnë aftësinë ripërtëritëse të tyre ndaj ndryshimit të mjedisit të shkaktuar nga njeriu. Speciet dhe habitatet detare janë të mbrojtura, ndikimi negativ i njeriut në biodiversitet parandalohet dhe komponentët e ndryshëm biologjike funksionojnë në ekuilibër;
 - ii. Veçoritë hidro-morfologjike, fizike dhe kimike të ekosistemeve, përfshirë edhe ato që janë rezultat i verimtarisë së njeriut në zonën në fjalë, i mbështesin ekosistemet e përshkruara më sipër. Futjet nga njeriu të substancave, energjisë dhe zhurmës, në mjedisin detar nuk shkaktojnë efekte ndotëse.
- k) **“Strategjia detare”** është strategjia që hartohet dhe zbatohet në lidhje me çdo rajon ose nënrajon detar.
- l) **“Ujëra detare”** janë:
 - i. ujërat, shtrati dhe nëntoka e detit në anën në drejtim të detit duke filluar nga vija e bregdetit deri në zgjatimin më të largët të ujërave territoriale ku Shqipëria ka dhe/ose ushtron juridiksionin, në përputhje me legjislacionin përkatës;
 - ii. ujërat bregdetare, siç përcaktohen në Ligjin No. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, shtrati dhe nëntoka e tyre, për aq kohë sa aspekte të veçanta të statusit mjedisor të mjedisit detar nuk mbulohen nga ky vendim.

V. RAJONET DHE NENRAJONET DETARE

- 7. Ministria në zbatim të këtij vendimi merr në konsideratë faktin se ujërat detare nën sovranitetin dhe juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, si pjesë integrale e rajonit të detit Mesdhe, janë të mbyllura, me baticë dhe rryma të kufizuara dhe përbëjnë një ekosistem të brishtë.
- 8. Ministria për të marrë parasysh veçoritë e këtij rajoni, zbaton këtë vendim duke iu referuar nënndarjeve të ujërave detare siç parashikohet në Kreun X, me kusht që ato të jenë të përfshira në nën-rajonet detare të mëposhtme:
 - a. Deti Adriatik;
 - b. Deti Jon dhe pjesa Qëndrore e Detit Mesdhe.

VI. STRATEGJIA E MJEDISIT DETAR

- 9. Ministria
 - a) Kontribuon për integrimin e problematikave mjedisore në politikat sektoriale, marrëveshjet dhe aktet ligjore që mund të kenë ndikim në mjedisin detar.
 - b) Koordinon bashkëpunimin me vendet e tjera që bëjnë pjesë në të njëjtin rajon apo nënrajon detar dhe përpiqet të sigurojë zbatojë një metodologji të përbashkët me to për përgatitjen e:
 - i. strategjisë detare për rajonin dhe nënrajonet përkatëse sic përcaktohet në paragrafin

- 10 gërma a;
- ii. programit të masave përkatëse sic përcaktohet në paragrafin 10 gërma b;
- c) Përgatit programin e masave të referuar në paragrafin 10 gërma b.

10. AKM për përgatitjen e strategjisë së referuar në paragrafin 9.b.i, kryen:

- i. Vlerësimin paraprak të statusit aktual mjedisor të ujërave në fjalë dhe ndikimin në mjedis të veprimtarisë së njeriut, në përputhje me Kreun IX brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ii. Përcaktimin e statusit të mirë mjedisor të ujërave në fjalë në përputhje me paragrafët 27 dhe 28 brenda 4 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- iii. Përcaktimin e objektivave mjedisore dhe treguesve përkatës, në përputhje me paragrafët 32 dhe 33 brenda 4 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- iv. Hartimin dhe zbatimin e programit të monitorimit për vlerësimin e vazhdueshëm dhe përditësimin e rregullt të objektivave, në përputhje me paragrafët 35, 36 dhe 37 brenda 4 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ;

11. Programi i masave i referuar në paragrafin 9 gërma c përfshin:

- i. Përcaktimin e masave për arritjen ose ruajtjen e statusit të mirë mjedisor, në përputhje me paragrafët 41, 42, 43, 44, 45, brenda 7 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ii. Futjen në veprim të masave të parashikuara në pikën i më sipër, në përputhje me paragrafin 50, brenda 8 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

12. Kur statusi i detit është aq kritik sa që kërkon ndërhyrje urgjente, Ministria përpiqet të sigurojë:

- a) Hartimin e një plani veprimi në përputhje me paragrafin 9.b.i dhe futjen sa më parë në veprim të programit të masave të përcaktuara sipas paragrafit 11.i dhe/ose
- b) Marrjen e masave më të rrepta mbrojtëse me kusht që ato të mos pengojnë arritjen apo ruajtjen e statusit të mirë mjedisor në një rajon apo nënrajon tjetër detar.

VII. BASHKËPUNIMI RAJONAL

13. Ministria aty ku është praktikisht e mundur dhe e përshtatshme përdor strukturat ekzistuese institucionale të bashkëpunimit rajonal, përfshirë Konventat Rajonale të Detit, që mbulojnë rajonin apo nënrajonin përkatës detar të përcaktuara në paragrafin 8, për të siguruar bashkëpunimin e parashikuar në paragrafin 9.b.

14. Ministria, për hartimin dhe zbatimin e strategjive detare për rajonin apo nënrajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8, bashkërendon veprimet me vendet e tjera që kanë sovranitet ose juridiksion mbi ujërat në të njëjtin rajon apo nënrajon detar duke shfrytëzuar forumet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë mekanizmat dhe strukturat e Konventave Rajonale të Detit ku Shqipëria është palë.

15. Ministria zhvillon programe dhe aktivitete në kuadër të strukturave që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, të tilla si Konventat Rajonale të Detit të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

16. Autoritetet përgjegjëse koordinojnë dhe bashkëpunojnë me të gjitha autoritetet përgjegjëse të vendeve të tjera në rajonin apo nënrajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8, përfshirë dhe vendet që nuk kanë dalje në det në zbatim të këtij vendimi, duke përdorur strukturat e vendosura të bashkëpunimit të përcaktuara në këtë vendim apo në Kreun II të ligjit Nr.111/2012, datë 15.11.20 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

VIII. AUTORITET PERGJEGJESE

17. Autoritetet përgjegjëse për hartimin e strategjisë së mjedisit detar janë ato që përgatisin Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të parashikuar në nenin 8 dhe 10 të ligjit No.111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".

18. Ministria përpilon listën e autoriteteve kombëtare përgjegjëse që marrin pjesë në organizmat ndërkombetare dhe që janë të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
19. Ministria përgatit listën e autoriteteve përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi, së bashku me informacionin e renditur në Shtojcën II.
20. Ministria dhe autoritetet përgjegjëse ndërmarrin çdo veprim të mundshëm për të siguruar bashkëpunimin brenda zonës së mbulimit të rajonit apo nënrajoneve detare të përcaktuara në paragrafin 8.
21. Të gjitha subjektet publike dhe private janë të detyruara që tu sigurojnë autoriteteve përgjegjëse të ngarkuara për përgatitjen e strategjisë së mjedisit detar të dhënat e nevojshme për këtë qëllim, sipas kërkesave të parashikuara në këtë vendim.

IX. VLERËSIMI

22. Në lidhje me rajonin apo nën-rajonet e përcaktuara në paragrafin 8, AKM përgatit paraprakisht vlerësimin e ujërave detare, duke marrë parasysh të dhënat ekzistuese të disponueshme, të cilat do të përfshijnë:
 - a) Analizën e tipareve dhe karakteristikave thelbësore dhe statusin aktual mjedisor të ujërave, bazuar në listat treguese të elementeve të përcaktuara në tabelën 1 të Shtojcës III, përfshirë karakteristikat fizike dhe kimike, tipet e habitateve, veçoritë biologjike dhe hidro-morfologjinë;
 - b) Analizën e faktorëve dhe ndikimeve mbizotërues, përfshirë veprimtarinë e njeriut, mbi statusin mjedisor të ujërave që:
 - i. bazohet në listat treguese të elementeve të përcaktuara në Tabelën 2 të Shtojcës III dhe përfshin tërësinë sasiore dhe cilësore të ndikimeve të ndryshme, si dhe prirjet e dukshme;
 - ii. mbulon efektet kryesore kumulative dhe sinergjike; dhe
 - iii. merr parasysh vlerësimet relevante të cilat janë bërë në pajtim me legjislacionin shqiptar në fuqi;
 - c) Analizën ekonomike dhe sociale të përdorimit të ujërave dhe të kostos së degradimit të mjedisit detar.
23. Analizat e parashikuara në paragrafin 22 do të marrin në konsideratë elementet në lidhje me ujërat bregdetare, territoriale dhe ndërkufitare që rregullohen nga dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar ekzistues, në veçanti të Ligjit Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.
24. Analizat e parashikuara në paragrafin 22 do të marrin gjithashtu në konsideratë, ose të përdorin si bazë të tyre, vlerësime të tjera të rëndësishme të kryera bashkërisht në kuadër të Konventave Rajonale të Detit, me synimin sigurimin e vlerësimit gjithëpërfshirës të gjendjes së mjedisit detar.
25. Për përgatitjen e vlerësimeve të parashikuara në paragrafin 22, Ministria nëpërmjet kordinimit dhe masave të parashikuara në Kreun VI dhe VII siguron që:
 - a) metodologjitë e vlerësimit të jenë të harmonizuara për të gjithë rajonin apo nën-rajonin detar të përcaktuara në paragrafin 8;
 - b) ndikimet dhe veçoritë ndërkufitare të jenë marrë parasysh.

X. PERCAKTIMI I STATUSIT TE MIRE MJEDISOR

26. Ministri nëpërmjet udhezimeve që nxjerr për rajonin apo nën-rajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8, përcakton grupin e karakteristikave që përbëjnë statusin e mirë mjedisor, në bazë të treguesve cilësorë të renditur në Shtojcën I, duke iu referuar vlerësimit paraprak të kryer në përputhje me paragrafin 22.
27. Ministri për përcaktimin e statusit të mirë mjedisor merr në konsideratë listën treguese të elementeve të paraqitur në Tabelën 1 të Shtojcës III, dhe në veçanti:
 - a. veçoritë fizike dhe kimike, tipet e habitateve, karakteristikat biologjike dhe hidro-morfologjike;

- b. faktorët dhe ndikimet e veprimtarisë së njeriut për rajonin apo nën-rajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8, duke pasur parasysh listat treguese të parashikuara në Tabelën 2 të Shtojcës III.
28. AKM, përveç përgatitjes së vlerësimit të parashikuar në paragrafin 22, përgatit edhe përcaktimin e statusit të mirë mjedisor në përputhje me paragrafin 27.
29. Ministri njofton institucionet europiane për vlerësimin e bërë në përputhje me Kreun IX dhe për përcaktimin e bërë në përputhje me paragrafin 27 të këtij kreu brenda tre muajve, pas përfundimit të këtij të fundit.
30. Ministri nxjerr udhëzime për kriteret dhe metodologjinë që do të përdoren për përgatitjen e vlerësimit të parashikuar në Kreun IX.

XI. VENDOSJA E OBJEKTIVAVE MJEDISORE

31. Ministri me urdhër përcakton grupin e plotë të objektivave mjedisore dhe treguesve në lidhje me ujërat detare për rajonin apo nënrajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8, me synim arritjen e statusit të mirë mjedisor në mjedisin detar.
32. Objektivat dhe treguesit e përmendur në paragrafin 31 vendosen:
- a. mbi bazën e vlerësimit paraprak të parashikuar në paragrafin 22; dhe
 - b. duke marrë në konsideratë:
 - i. listat treguese të faktorëve dhe ndikimeve të përfshira në Tabelën 2 të Shtojcës III;
 - ii. listat treguese të veçorive të përfshira në Shtojcën IV;
 - iii. zbatimin e vazhdueshëm të objektivave të cilat janë përcaktuar në nivel kombëtar, apo ndërkombëtar në lidhje me ujërat në fjalë
 - iv. ndikimet dhe veçoritë ndërkufitare sa më shumë që të jetë e mundur;
 - v. që ato të jenë reciprokisht në përputhje me objektivat e përmendura në paragrafin 32/b.iii.
33. Ministri brenda tre muajve nga vendosja e objektivave mjedisore njofton institucionet europiane dhe kur është e nevojshme edhe organet drejtuese të Konventave Rajonale të Detit.

XII. PROGRAMET E MONITORIMIT

34. Ministri miraton programet e koordinuara të monitorimit për vlerësimin e vazhdueshëm të statusit mjedisor të ujërave detare.
35. Programi i monitorimit i parashikuar në paragrafin 34 i referohet objektivave mjedisore të parashikuara në Kreun XI dhe bazohet në:
- a) Vlerësimin paraprak të kryer në mbështetje të paragrafit 22;
 - b) Listën treguese të elementeve të përfshira në Shtojcën III;
 - c) Listën e përfshirë në Shtojcën V.
36. Programet e monitorimit duhet të jenë:
- a) të bashkërenduara brenda rajonit dhe nën-rajoneve detare të përcaktuara në paragrafin 8; dhe
 - b) në përputhje me dispozitat përkatëse për vlerësim dhe monitorim të përcaktuara nga:
 - i. legjislacioni shqiptar, përfshirë atë për natyrën; dhe
 - ii. marrëveshjet ndërkombëtare.
37. Ministria, në përputhje me paragrafin 35 harton programe monitorimi për rajonin apo nënrajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8 dhe në interes të koherencës dhe koordinimit siguron që:
- a) metodat e monitorimit janë të qëndrueshme në të gjithë rajonin ose nën-rajonet detare në mënyrë që rezultatet e monitorimit të jenë lehtësisht të krahasueshme.
 - b) ndikimet dhe veçoritë përkatëse ndërkufitare janë marrë në konsideratë
38. AKM zbaton programin e monitorimit dhe vlerësimit.

39. Ministria njofton institucionet europiane përkatëse dhe kur është e nevojshme edhe organet drejtuese të Konventave Rajonale të Detit për programin e monitorimit brenda tre muajve nga hartimi i tij.

XIII. PROGRAMET E MASAVE

40. Ministria identifikon masat që duhen ndërmarrë për të arritur apo mbajtur statusin e mirë mjedisor në ujërat detare, siç parashikohet në Kreun X, për rajonin apo nënrajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8.

41. Masat e parashikuara në paragrafin 40 hartohen:

- a) mbi bazën e vlerësimit paraprak të bërë në përputhje me paragrafin 22;
- b) duke iu referuar objektivave mjedisore të parashikuara në Kreun IX;
- c) duke marrë parasysh llojet e masave të renditura në Shtojcën VI.

42. Ministria integron masat e hartuara që parashikohen në paragrafin 41 në një program masash që përfshin:

- a) masat respektive të parashikuara në legjislacionin shqiptar;
- b) legjislacionin përkatës në lidhje standartet cilësore mjedisore në fushën e politikave të ujërave;
- c) marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë.

43. Ministria në hartimin e programit të masave të parashikuara në paragrafin 42:

- a) Merr në konsideratë:
 - i. zhvillimin e qëndrueshëm; dhe në veçanti
 - ii. ndikimin ekonomik dhe social të masave që parashikohen.
- b) Mund të identifikojë ose krijojë kuadër administrativ plotësues dhe të përfitojë nga ky ndërveprim për të ndihmuar autoritet/in/et përgjegjës/e të parashikuara/a në këtë Vendim për të ndjekur objektivat në mënyrë të integruar.

44. Ministria para futjes së masave të reja siguron që:

- a) Ato të jenë teknikisht të realizueshme dhe kostot e tyre të justifikohen nga përfitimet; dhe
- b) të kryehen vlerësimet e ndikimit të tyre në mjedis, përfshirë analizat kosto-përfitim,

45. Programet e masave të hartuara në përputhje me këtë kre përfshijnë:

- a) masat për mbrojtjen e territorit që kontribuojnë në rrjetet koherente dhe përfaqësuese të zonave të mbrojtura detare. Këto masa duhet të mbulojnë në mënyrë adekuate shumëllojshmërinë e përbërjes së ekosistemeve, të tilla si zonat e veçanta të ruajtjes dhe zonat e vecanta të mbrojtjes në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- b) zonat e mbrojtura detare, të miratuara nga Ministria në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare ose rajonale ku Republika e Shqipërisë është palë.

46. Kur Ministria konstaton se menaxhimi i veprimtarisë së njeriut brenda territorit të Shqipërisë ose jashtë saj ka gjasa të ketë ndikim të rëndësishëm mbi mjedisin detar, veçanërisht në zonat e trajtuara në paragrafin 45, vetë ose bashkë me shtete të tjera të interesuara, i kërkon autoritetit përgjegjës ose organizatave ndërkombëtare përkatëse të konsiderojë shqetësimet dhe mundësisht të marrë masa që mundësojnë, sipas rastit, ruajtjen apo rikthimin e integritetit, strukturës dhe funksionimit të atyre ekosistemeve.

47. Ministria brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi publikon për rajonin ose nënrajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8, informacionet përkatëse për zonat e parashikuara në paragrafët 45 dhe 46.

48. Ministria siguron që programet e masave të jenë të zbatueshme dhe të kontribuojnë në arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në përputhje me Kreun XI.

49. Ministria merr në konsideratë edhe ndikimet që programet e masave mund të kenë mbi ujërat përtej ujërave detare, në mënyrë që të minimizohet rreziku i dëmtimit të tyre, dhe nqse është e mundur, të sjellë një ndikim pozitiv mbi to.

50. Ministria, brenda tre muajve nga hartimi i programeve të masave, i njofton ato pranë institucioneve europiane përkatëse dhe kur është e nevojshme edhe pranë organeve drejtuese të Konventave Rajonale të Detit.

51. Ministria garanton që programet e masave të fillojnë të zbatohen brenda një viti nga hartimi i tyre.

XIV. PERJASHTIMET

52. Ministria mund të identifikojë për ujërat e saj detare nivelet ku për ndonjë nga arsyet e renditura në germa a deri në d, objektivat mjedisore apo statusi i mirë mjedisor nuk mund të arrihen në ndonjë aspekt, apo që për arsyet e përmendura nën germën e, nuk mund të arrihen brenda afatit kohor në fjalë:

- a) veprimet ose mosveprimet, për të cilat Ministria nuk është përgjegjëse;
- b) shkaqe natyrore;
- c) forca madhore;
- d) modifikimi apo ndryshimi i karakteristikave fizike të ujërave detare si pasojë e veprimeve të ndërmarra për interes publik, të cilat tejkalojnë ndikimin negativ në mjedis, përfshirë edhe ndikimin ndërkufitar;
- e) kushtet natyrore që nuk lejojnë përmirësim në kohë në statusin e ujërave detare në fjalë.

53. Ministria identifikon qartë në programin e saj të masave rastet e referuara në paragrafin 52 dhe mbron pikëpamjen e saj pranë institucioneve europiane dhe nëse është e nevojshme pranë organeve drejtuese të Konventave Rajonale të Detit.

54. Në identifikimin e rasteve të tilla Ministria merr parasysh pasojat për shtete tjera në rajonin apo nënrajonin përkatës detar të përcaktuara në paragrafin 8. Megjithatë Ministria merr masa të përshtatshme ad-hoc që synojnë:

- a) arritjen e objektivave mjedisore;
- b) zbutjen e ndikimit negativ në nivelin përkatës të rajonit apo nënrajonit detar të përcaktuara në paragrafin 8 ose në ujërat detare të shteteve të tjera.

55. Në situatën e parashikuar në paragrafin 52, germa d, Ministria siguron që modifikimet apo ndryshimet nuk përjashtojnë apo nuk rrezikojnë në mënyrë të përhershme arritjen e statusit të mirë mjedisor në rajonin apo nënrajonin detar në fjalë apo në ujërat detare të shteteve të tjera.

56. Masat ad-hoc të parashikuara në paragrafin 53 do të integrohen sa më shumë të jetë e mundur në programet e masave.

57. Ministria harton dhe zbaton të gjithë elementet e strategjive të mjedisit detar të parashikuara në paragrafin 11.

58. Me përjashtim të vlerësimit paraprak të parashikuar në Kreun IX, Ministria nuk ka nevojë të ndër marrë masa të veçanta në rastet kur:

- a) nuk ka rrezik të konsiderueshëm për mjedisin detar;
- b) kostot janë jo proporcionale duke marrë parasysh rreziqet për mjedisin detar, me kushtin që nuk ka përkeqësim të mëtejshëm të tij.

XV. PERDITESIMI

59. Ministria shqyrton në mënyrë të koordinuar çdo gjashtë vjet dhe përditëson strategjitë detare për rajonin apo nën-rajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8.

60. Shqyrtimi, siç parashikohet në Kreun VI, përfshin elementet e mëposhtëm të strategjive detare:

- a) vlerësimin fillestar dhe përcaktimin e statusit të mirë mjedisor, siç parashikohet respektivisht në paragrafin 22 dhe paragrafin 26;
- b) objektivat mjedisore të hartuara në përputhje me Kreun XI;
- c) programet e monitorimit të hartuara në përputhje me Kreun XII;
- d) programet e masave të hartuara në përputhje me Kreun XIII.

61. Detajet e çdo përditësimi të bërë pas rishikimit të parashikuar në paragrafin 60 i dërgohen institucioneve europiane dhe nëse është e nevojshme edhe organeve drejtuese të Konventave Rajonale të Detit brenda tre muajve nga publikimi i tyre.

XVI. RAPORTIMI

62. Ministria brenda tre viteve nga publikimi i programit të masave ose nga përditësimi i tyre në përputhje me këtë vendim i dërgon institucioneve europiane dhe nëse është e nevojshme edhe organeve drejtuese të Konventave Rajonale të Detit një raport përmbledhës përshkrues për progresin e bërë në zbatim të programit të masave.

XVII. KONSULTIMI ME PUBLIKUN DHE INFORMIMI

63. Në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi Ministria siguron që të gjitha palëve të interesuara tu jenë dhënë mundësi të hershme dhe efektive për të marrë pjesë në zbatimin e këtij vendimi, duke përfshirë kur është e mundur organet apo strukturat ekzistuese të menaxhimit, Konventat Rajonale të Detit, Organet Këshillimore Shkencore dhe Këshillat Rajonale Këshillimore.

64. Ministria publikon dhe vë në dispozicion të publikut për komente, përmbledhjet e elementeve të mëposhtme të strategjive detare ose përditësimet e lidhura me to, si më poshtë:

- a)** vlerësimin paraprak dhe përcaktimin e statusit të mirë mjedisor, siç parashikohet respektivisht në paragrafin 22 dhe paragrafin 27 ;
- b)** objektivat mjedisore të hartuara në përputhje me paragrafin 32;
- c)** programet e monitorimit të hartuara në përputhje me paragrafin 35;
- d)** programet e masave të hartuara në përputhje me paragrafin 42.

65. Aksesit në informacionin mjedisor jepet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Në mënyrë të vecantë:

- a)** Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të ketë dhe/ose të përdorë informacion në lidhje me ujërat detare.
- b)** Publiku duhet të informohet në lidhje me burimet e informacionit dhe menaxhimin e integruar të ujërave.
- c)** Publikut i jepet informacioni i mundshëm shtesë mbi planet e menaxhimit të baseneve ujore.

XVIII. DISPOZITA TE FUNDIT DHE KALIMTARE

66. Ministri është përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore të kërkuar nga paragrafi 26, 30, 34 të këtij Vendimi.

67. Ministri ka të drejtë të nxjerrë edhe akte të tjera nënligjore për zbatimin e këtij vendimi.

68. Çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi shfuqizohet.

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në fletoren zyrtare.

Efektet ligjore fillojnë një vit pas publikimit në fletoren zyrtare.

**KRYEMINISTRI
EDI RAMA**

SHTOJCA I

Treguesit cilësorë për përcaktimin e statusit të mirë mjedisor

(Referuar në Kreun IV/germa f, paragrafi 26)

- 1.** Ruajtja e diversitetit biologjik. Cilësia dhe përhapja e habitateve, shpërndarja dhe bollëku i specieve janë në përputhje me kushtet mbizotëruese fiziografike, gjeografike dhe klimatike.
- 2.** Speciet jo-indigjene të futura nga veprimtaria e njeriu janë në nivele që nuk i ndryshojnë negativisht ekosistemet.
- 3.** Dendësia e peshqve dhe butakëve që shfrytëzohen për qëllime tregtie janë brenda limiteve të sigurta biologjike, duke ekspozuar një moshë dhe sasi shpërndarje që flet për një gjendje të shëndetshme të tyre.
- 4.** Të gjithë elementët e ushqimeve të detit, deri në masën që ato janë të njohura, gjenden në sasi normale dhe nivel diversiteti të tillë që siguron bollëkun afatgjatë të specieve dhe mbajtjen e kapacitetit të plotë riprodhues të tyre.
- 5.** Eutrifikimi i shkaktuar nga njeriu minimizohet, sidomos efektet negative të tilla si humbjet në biodiversitet, degradimi i ekosistemit, shtimin e algave të dëmshme dhe pamjaftueshmëria e oksigjenit në ujërat e poshtme.
- 6.** Fundi i detit është në një nivel që siguron se struktura dhe funksionet e ekosistemeve janë të mbrojtura dhe veçanërisht ekosistemet bentike nuk janë prekur negativisht.
- 7.** Ndryshimi i përhershëm i kushteve hidrografike, nuk do të ndikojë negativisht mbi ekosistemet detare.
- 8.** Përqendrimet e ndotësve janë në nivele të tilla që nuk shkaktojnë ndotje.
- 9.** Ndotësit e peshqve dhe prodhimeve të detit që janë për konsum njerëzor nuk i tejkalojnë nivelet e përcaktuara nga legjislacioni specifik në fuqi ose standarte të tjera relevante.
- 10.** Vetitë dhe sasi të mbetjeve në det nuk shkaktojnë dëm në mjedisin bregdetar dhe detar.
- 11.** Futja e energjisë, duke përfshirë zhurmën nënujore, është në nivele që nuk ndikojnë negativisht në mjedisin detar.

Për të përcaktuar karakteristikat e statusit të mirë mjedisor në rajonin ose nën-rajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8 siç parashikohet në Kreun VIII, paragrafi 27 dhe 28, autoritetet përgjegjëse marrin në konsideratë secilin nga treguesit cilësorë të renditur në këtë Shtojcë, për të identifikuar ata tregues që do të përdoren për të përcaktuar statusin e mirë mjedisor për atë rajon ose nën-rajon detar.

SHTOJCA II
Autoritetet përgjegjëse
(Referuar në /paragrafin 19)

1. Emri dhe adresa e autoritet/it/eve përgjegjës/e - emri zyrtar dhe adresa e autoritet/it/eve përgjegjës/e të identifikuar.
2. Statusi ligjor i autoritet/it/eve përgjegjës/e - një përshkrim i shkurtër i statusit juridik të autoritet/it/eve përgjegjës/e.
3. Përgjegjësitë - një përshkrim të shkurtër të kompetencave ligjore dhe administrative të autoritet/it/eve përgjegjës/e, si dhe roli i tyre në lidhje me ujërat detare në fjalë.
4. Anëtarësia - kur autoritet/i/et përgjegjës/e veprojnë si organ koordinues për autoritetet e tjera përgjegjëse, përgatitet lista e këtyre të fundit së bashku me një përmbledhje të marrëdhënieve institucionale të vendosura me qëllim për të siguruar koordinim ndërmjet tyre.
5. Koordinimi rajonal ose nën-rajonar - përmbledhje e mekanizmave të krijuara për të siguruar koordinim ndërmjet shteteve, ujërat detare të të cilëve bien brenda të njëjtit rajon apo nën-rajon detar.

SHTOJCA III

Listat treguese të karakteristikave, presioneve dhe ndikimeve

(Referuar në paragrafin 23; paragrafi 27; paragrafi 32; paragrafi 35)

Tabela 1 - Karakteristikat

Tiparet fizike dhe kimike	<ul style="list-style-type: none"> - Topografia dhe batimetria e shtratit të detit - Regjimi vjetor dhe sezonal i temperaturës dhe mbulimi me akull, shpejtësia aktuale, valëzimi, karakteristika të përzjershmërisë, çrregullime, koha e qëndrimit, - Shpërndarja hapësinore dhe kohore e kripësisë, - Shpërndarja hapësinore dhe kohore elëdëve ushqyese (DIN, TN, DIP, TP, TOC) dhe oksigjen, - profilet e PH, pCO₂ apo informacion i ngjashëm i përdorur për të matur acidifikimin e detit.
Tipet e habitateve	<ul style="list-style-type: none"> - Tip/i/et mbizotërues/e i/të habitateve të shtratit dhe kollonës së ujit të detit me një përshkrim të karakteristikave kimike dhe fizike, si thellësia, regjimi i temperaturës së ujit, korentet dhe lëvizje të tjera të ujërave, kripësia, përbërja e nënshtresave të shtratit të detit, - Identifikimi dhe hartëzimi i habitateve të veçanta, sidomos të atyre që sipas legjislacionit specifik në fuqi ose konventave ndërkombëtare kanë interes të veçantë shkencor apo për biodiversitetin, - Habitatet në zonat të cilat për shkak të karakteristikave të tyre, vendndodhjes apo rëndësisë strategjike meritojnë një vëmendje të veçantë. Kjo mund të përfshijë zonat ku ka presione intensive ose specifike apo zonat të cilat kërkojnë regjim të veçantë mbrojtjeje.
Tiparet biologjike	<ul style="list-style-type: none"> - Një përshkrim i komuniteteve biologjikeshoqëruese të habitateve mbizotëruese të shtratit të detit dhe kolonës së ujit. Ky përfshin informacion mbi komunitetet e fitoplanktonëve dhe zooplanktoneve dhe speciet dhe ndryshueshmërinë sezonale dhe gjeografike, - Informacion mbi bimët farëzhveshura, makro-algat dhe faunën invertetbre të fundit të detit, përbërjen e specieve, biomasën dhe ndryshueshmërinë vjetore/sezonale dhe gjeografike, - Informacion mbi strukturën e popullatave të peshkut, duke përfshirë bollëkun, shpërndarjen dhe strukturën sipas moshës/madhësisë së popullatave, - Një përshkrim të dinamikës së popullatës, shpërndarja natyrore dhe aktuale dhe statusi i specieve të gjitarëve detare dhe zvarranikeve që ndodhen në atë rajon ose nën-rajon detar, - Përshkrim të dinamikës së popullatës, shpërndarje natyrore dhe aktuale dhe statusi i specieve të zogjve të detit që ndodhen në rajonin apo nën-rajonin detar, - Përshkrim të dinamikës së popullatës, shpërndarjen natyrore dhe aktuale dhe statusi i specieve të tjera që ndodhen në rajonin apo nën-rajonin detar, të cilat i nënshtrohen legjislacionit specifik në fuqi apo marrëveshjeve ndërkombëtare, - Inventar të shpeshtësisë së ndodhjes, bollëkut dhe shpërndarjes hapësinore të specieve jo-indigjene, ekzotike apo, kur është e nevojshme, format gjenetike të dallueshme të specieve autoktone, që janë të pranishme në atë rajon ose nën-rajon detar.
Tipare të tjera	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrim të situatës në lidhje me kimikatet, përfshirë ato që shkaktojnë çrregullim, ndotje të sedimenteve, zona të nxehta, probleme shëndetësore

	dhe ndotje të biotës (sidomos asaj që destinohet për konsum njerëzor), - Përshkrim të karakteristikave apo të tipareve të tjera tipike apo specifike për atë rajon apo nën-rajon detar.
--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Tabela 2- Presionet dhe ndikimet

Humbja fizike	<ul style="list-style-type: none"> - Pengesat (p.sh. struktura të bëra nga njeriu, depozitimi i objekteve të fundosur), - betonimi (p.sh. me ndërtime të përhershme)
Dëmi fizik	<ul style="list-style-type: none"> - Ndryshime në baltëzim (p.sh. nga derdhja/depozitimi i objekteve të fundosur), - abrazioni (p.sh. ndikimi në shtratin e detit për shkak të peshkimit komercial, shëtitjeve me varkë, ankorimit të anijeve), Nxjerrja selektive (p.sh. eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve të gjalla dhe jo të gjalla nga shtrati i detit dhe nëntoka).
Crregullime të tjera fizike	<ul style="list-style-type: none"> - Zhurma nënujore (p.sh. nga anijet, pajisjet nënujore akustike) - mbetjet e shkarkuara në det që lundrojnë në sipërfaqe të tij.
Ndërhyrje në proceset hidrologjike	<ul style="list-style-type: none"> - Ndryshime të rëndësishme në regjimin termik (p.sh. nga shkarkimet e stacioneve të energjisë), - Ndryshime të rëndësishme në regjimin e kripësisë (p.sh. nga ndërtimet që pengojnë lëvizjet e ujit, nxjerrjen e ujit).
Ndotja nga substancat e rrezikshme	<ul style="list-style-type: none"> - Futja e përbërësve sintetike (p.sh. substancat prioritare sipas ligjit nr.111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” dhe akteve nënligjore në fuqi që burojnë prej tij, të cilat kanë rëndësi për mjedisin detar të tilla si pesticidet, produkte farmaceutike, që rezultojnë psh nga humbjet prej burimeve të shpërndara, ndotjet nga anijet, depozitimet atmosferike dhe substancat biologjikisht aktive), - Futja e substancave dhe përbërësve jo sintetike (p.sh. metalet e rënda, hidrokarburet, që rezultojnë për shembull nga ndotjet nga anijet dhe kërkimi dhe nxjerrja e gazit, naftës dhe mineraleve, depozitimet atmosferike, prurjet nga lumenjtë), - Futja e radionuklideve.
Clirimi sistematik dhe/ose i qëllimshëm i substancave	<ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i substancave të tjera, të ngurta, të lëngshme ose të gazta, në ujërat detare, që rezultojnë nga shkarkimet sistematike dhe/ose të qëllimshme në mjedisin detar, të lejuara nga legjislacioni specifik në fuqi dhe/ose nga konventat ndërkombëtare.
Pasurimi me elemente organike dhe ushqyes	<ul style="list-style-type: none"> - Futja e plehrave kimike dhe substancave të tjera të pasura me azot dhe fosfor (p.sh. nga burime të identifikueshme dhe burime të shpërndara, përfshirë bujqësinë, akuakulturën, depozitimet atmosferike), - Futja e lëndëve organike (p.sh., nga kanalizimet, marikultura, prurjet e lumenjve).
Crregullime biologjike	<ul style="list-style-type: none"> - Futja e patogjenëve mikrobialë, - Futja e specieve jo-autoktone dhe zhvendosja e tyre, - Nxjerrja selektive e specieve, përfshirë kapjet rastësore aksidentale (p.sh. nga peshkimi për qëllime tregtie dhe argëtimi).

SHTOJCA IV

Lista treguese e karakteristikave që duhen marrë parasysh për përcaktimin e objektivave mjedisore

(Referuar në Kreun IX/paragrafi 32)

1. Mbulimi i përshtashëm i elementeve që karakterizojnë ujërat detare nën sovranitetin apo juridiksionin e Republikës së Shqipërisë brenda rajonit apo nën-rajoneve detare të përcaktuara në paragrafin 8.
2. Duhet të përcaktohen:
 - a) objektivat që krijojnë kushtet e dëshiruara bazuar në përcaktimin e statusit të mirë mjedisor;
 - b) objektivat e matshëm dhe treguesit shoqërues që lejojnë monitorimin dhe vlerësimin; dhe
 - c) objektivat operacionale lidhur me masat zbatuese konkrete që mbështesin arritjen e tyre.
3. Përcaktimi i statusit mjedisor që synohet të arrihet apo të ruhet dhe formulimi i tij në lidhje me vetitë e matshme të elementeve që karakterizojnë ujërat detare të Republikës së Shqipërisë në rajonin apo nën-rajonet detare të përcaktuara në paragrafin 8.
4. Konsistenca e grupit të objektivave; mungesa e konflikteve midis tyre.
5. Përcaktimi i burimeve të nevojshme për arritjen e objektivave.
6. Formulimi i objektivave, përfshirë edhe objektivat e ndërmjetme dhe grafikun kohor për arritjen e tyre.
7. Përcaktimi i treguesve që synojnë të monitoriojnë progresin dhe vendimet udhëzuese të menaxhimit me synim arritjen e objektivave.
8. Ku është e përshtatshme, përcaktimi i pikave të referencës (për objektivat dhe limitet).
9. Marrja parasysh e shqetësimeve sociale dhe ekonomike në përcaktimin e objektivave.
10. Shqyrtimi i grupit të objektivave mjedisore, treguesve shoqërues dhe pikave të referimit të objektivave dhe limitit të tyre të zhvilluara në dritën e objektivave mjedisore të përcaktuar në Kreun II, për të vlerësuar nëse arritja e objektivave do të bënte që ujërat detare nën sovranitetin apo juridiksionin e Republikës së Shqipërisë në rajonin detar të përcaktuar në paragrafin 8 të kishin një status që përputhet me to.
11. Përputhja e këtyre objektivave me objektivat për të cilat Republika e Shqipërisë është zotuar në marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale, duke përdorur ato që janë më të rëndësishme për rajonin apo nën-rajonin detar në fjalë me qëllim arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në Kreun II.
12. Pasi të jenë përcaktuar objektivat dhe treguesit, ato duhet të shqyrtohen së bashku përkundrejt objektivave mjedisore të përcaktuara në Kreun II, duke vlerësuar nëse arritja e objektivave do ta çojë mjedisin detar në një status që përputhet me to.

SHTOJCA V
Programet e monitorimit
(Referuar në Kreun X/paragrafin 35)

1. Duhet të sigurojnë informacion për vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe për vlerësimin e diferencës midis gjendjes aktuale dhe statusit të mirë mjedisor në përputhje me Shtojcën III dhe me kriteret dhe standardet metodologjike që duhen përcaktuar sipas Kreut X.
2. Duhet të garantojnë gjenerimin e informacionit që mundëson identifikimin e treguesve të përshtatshëm për objektivat mjedisore të parashikuara në Kreun XI.
3. Duhet të garantojnë gjenerimin e informacionit që lejon vlerësimin e ndikimit të masave të parashikuara në Kreun XIII.
4. Duhet të përfshijnë veprimtari që identifikojnë shkakun e ndryshimit dhe masat e mundshme korrigjuese që do të duhet të merren për të rivendosur statusin e mirë mjedisor, kur janë identifikuar devijime nga statusi i synuar.
5. Duhet të sigurojnë informacion mbi ndotesit kimik mbi speciet e destinuar për konsum njerëzor nga zonat e peshkimit komercial.
6. Duhet të përfshijnë aktivitetet që konfirmojë se masat korrigjuese të sjellin ndryshimet e dëshiruara dhe jo efekte anësore të padëshiruara.
7. Duhet të grupojnë informacionet përkatëse për rajonin apo nën-rajonin detar në pajtim me Kreun V.
8. Duhet të sigurojnë krahasueshmërinë e metodave të vlerësimit brenda dhe midis rajoneve dhe nën-rajoneve detare.
9. Duhet të zhvillojnë specifikime teknike dhe metoda të standardizuara për monitorimin në nivel kombëtar, që mundësojnë krahasueshmërinë e informacionit.
10. Duhet të sigurojnë, aq sa është e mundur, përputhshmëri me programet ekzistuese të zhvilluara në nivel rajonal dhe ndërkombëtar me qëllim nxitjen e bashkërendimit ndërmjet këtyre programeve duke shmangur dublikimin e përpjekjeve, duke përdorur udhëzimet më të përshtatshmet për monitorimin e rajonit apo nën-rajonit detar në fjalë.
11. Duhet të përfshijnë vlerësimin e ndryshimeve të mëdha të kushteve mjedisore dhe, kur është e nevojshme, problematika të tjera që shfaqen, si pjesë të vlerësimit paraprak të parashikuar në Kreun IX.
12. Duhet të trajtojnë, si pjesë të vlerësimit paraprak të parashikuar në Kreun IX, elementet përkatëse të renditura në Shtojcën III përfshirë ndryshueshmërisë e tyre natyrore dhe të vlerësojnë tendencat për arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në përputhje me paragrafin 32 dhe 33, duke përdorur, sipas rastit, treguesit e hartuar dhe pikat e referencës për limitin dhe objektivin e tyre.

SHTOJCA VI
Programet e masave
(Referuar në Kreun XI/paragrafi 41)

1. Kontrollin e inputeve: Masat e menaxhimit që ndikojnë në sasinë e veprimtarive të lejuara të njeriut.
2. Kontrollin e output: Masat e menaxhimit që ndikojnë në shkallën e lejuar të shqetësimit të një përbërësi të ekosistemit.
3. Kontrollin hapësinor dhe kohor të shpërndarjes: masa menaxhuese që ndikojnë në vendin dhe në kohën kur lejohet të ndodhë aktiviteti.
4. Masat për koordinimin e menaxhimit: mjete që sigurojnë që menaxhimi të jetë i koordinuar.
5. Masat për përmirësimin e gjurmueshmërinë të ndotjes detare aty ku është e mundur.
6. Stimuj ekonomikë: masa menaxhimi që bëjnë që përdoruesit e ekosistemeve detare, t'i përdorin ato në mënyra që ndihmojnë të arrihet objektivi i statusit të mirë mjedisor.
7. Mjetet zbutëse dhe rehabilituese: mjetet e menaxhimit që udhëheqin veprimtaritë e njeriut drejt rehabilitimit të komponentëve të dëmtuar të ekosistemeve detare.
8. Komunikimi, përfshirja e aktorëve dhe rritja e ndërgjegjësimit publik.